



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlasna

Nr. -1-108  
Br.

Data 17.08.2023  
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

## KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

### E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.07.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

**Të pranishëm te tjerë:** drejtorët komunal, dhe Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2022
4. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja
5. Rishikimi i buxhetit për vitin 2023
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (6) të punës së DEFZH-së, për vitin 2023
7. Raporti gjashtëmujor (6) i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023
8. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-99, të dt.30.10.2017
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 6 vota për.

#### **I. Pika e parë e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **II.Pika e dytë e rendit të ditës**

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

#### **III.Pika e tretë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** –Paraqet shqyrtimin e raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2022.

**Enver Gashi** –Mendoj se grupi ynë është për me shkue në Kuvend ky raport dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti**- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të përgjithshëm është një çështje shumë normale dhe është shumë mirë që vjen në seancë dhe atje, do të bisedojmë për vërejtjet tona, por gjithsesi se jemi edhe për këtë edhe për pikën vijuese, që të shkoj në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota "PËR" i rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2022.

#### **IV. Pika e katërtë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** - Paraqet Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja.

**Enver Gashi** –Edhe për Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja, jemi dakord që të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

**Sami Ahmeti** –Gjithsesi e thamë edhe më heret, kjo pikë ndërlidhet me pikën paraprake, kështu që jemi që kjo të shkoj në seancë dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota "PËR" i rekomanduan Kuvendit Komunal Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja.

#### **V. Pika e prstë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** –Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për rishikimin e buxhetit për vitin 2023.

**Enver Gashi** –Ne jemi për atë që rishikimi i buxhetit për vitin 2023 të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë si anëtarë të Kuvendit.

**Sami Ahmeti** –Unë nuk kam parë shpjegime taman ashtu qysh do të duhej të ishin, gjithsesi e di se do të shkon në Kuvend dhe ne fillimisht do të abstenojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota "PËR" dhe 2 vota abstenim i rekomanduan Kuvendit Komunal Rishikimin e buxhetit për vitin 2023.

#### **VI. Pika e gjashtë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** –Paraqet shqyrtimin e raportit gjashtëmuor (6) të punës së DEFZH-së, për vitin 2023.

**Enver Gashi** –Ne jemi për atë që shqyrtimi i raportit gjashtëmuor të shkoj në Kuvend.

**Sami Ahmeti** –Edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota "PËR" I rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e raportit gjashtëmuor (6) të punës së DEFZH-së, për vitin 2023.

#### **VII. Pika e shtatë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e raportit gjashtëmuor (6) të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023.

**Enver Gashi** –Edhe për këtë raport jemi për atë që të shkoj në Kuvend sepse jemi në ngjarje, e kemi parë dhe është taman raport i punës dhe opozita ka mundësi me iu bë pyetje drejtorëve, e ata të na japin sqarime.

**Sami Ahmeti**– E tha parafolësi atë që deshta me thënë se jemi në rregullë që të shkoj në seancë, vetëm shpresojmë se do të lejohet debati, nuk do të ketë interferime dhe do të lejohet me bë debat taman qysh duhet.

**Kryesuesja** - Patjetër z.Ahmeti, për atë edhe jemi këtu për një debat frytdhënës, ashtu edhe qysh na takon.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota "PËR" I rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin gjashtëmujor (6) të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023.

### **VIII. Pika e tetë e rendit të ditës**

**Kryesuesja** –Paraqet shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-99, të dt.30.10.2017. Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit duhet të bëhet sipas Ligjit nr.04/L-174, të Ligjit të Planifikimit Hapësinor në nenin 2, rendi 8 dhe neni 9 ku periudha nëntë (9) vjeçare duhet të zëvendësohet me periudhën 8 vjeçare.

**Enver Gashi** –Ne jemi për atë që kjo kërkesë të shkoj për shqyrtim në Kuvend.

**Sami Ahmeti** –Edhe ne jemi dakord që të shkoj në Kuvend, fillimisht kjo pikë kërkohet pas miratimit të një dokumenti paraprakisht që kërkon këtë 8 vjeçar, kështu që prej këtu ju garantojmë se vota jonë është për sepse është diçka që paraprakisht kemi miratuar në Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota "PËR" ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-99, të dt.30.10.2017.

### **IX. Pika e nënte e rendit të ditës**

**Kryesuesja** –Paraqet kërkesën nga Kryetari i Komunës, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-19, të dt.04.02.2019,të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), pas tërheqjes së znj.Valbona Beka, Drejtorja e Arsimit ka emëruar Kryetarin e ri të Këshillit të prindërve, z.Naim Shabani.

**Enver Gashi** –Ne jemi për atë që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

**Sami Ahmeti** –Edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota "PËR" ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën nr.-II-1009, të dt.19.07.2023, të Kryetarit të Komunës për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-19, të dt.04.02.2022, lidhur me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

**Kryesuesja** – Paraqet kërkesën nga Qerim Preniqi, nga banorët segmenti i rr: 'Janina" dhe ju të nderuar anëtarë të KPF-së, nëse doni me trajtue dhe me ia dërgue DPUKP-së, apo doni që të mbetet për mbledhjen tjetër.

**Enver Gashi** -Është kërkesë që duhet me shqyrtue DPUKP-ja, pastaj të na vjen neve në Kuvend për aprovim.

**Sami Ahmeti** – Tash, ndoshta kjo kërkesë e llojit të njëjtë është e 20-ta, ose e 30-ta, brenda mandatit tonë sa jemi dhe vazhdimisht kemi bërë kërkesë që kjo të shkoj në Drejtorinë përgjegjëse. Është një Komision që është themeluar prej Kuvendit dhe Ekzekutivit që merret me këtë çështje dhe a është e arsyeshme, apo nuk është le të vjen fillimisht Drejtorja me përgjegje të saj, pastaj bisedojmë në Kuvend. Këto kërkesa që vijnë është mirë pasi të shqyrtohen të vijnë në Kuvend. Edhe unë jam dakord që nëse, e kemi bërë një standard që kërkesat të shkojnë në Drejtorinë gjegjëse, të gjitha sepse tani po krijohet një përshtypje se po bëhen pranime selektive.

**Kryesuesja**– Patjetër që po dhe unë ju thashë se a pajtoheni që me i rekomandue vetëm Drejtorisë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota "PËR" ia rekomanduan DPUKP-së, për shqyrtim kërkesën nr.-I- 19018/23,të dt.20.07.2023 dhe në Kuvend të vjen me një sqarim.

**Kryesuesja**– Paraqet kërkesën nga Kryetari i Komunës, raporti i Komisionit për vlerësimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale.

**Enver Gashi** – Ne jemi dakord që ky raport ti rekomandohet Kuvendit komunal.

**Sami Ahmeti**– Çdo herë kur ka raporte, aq më tepër për transparencë jemi dakord edhe me qenë ditë e diele, edhe me qenë jashtë orarit të punës, jemi dakord që ajo të trajtohet. Gjithsesi, qysh e thashë më heret me shpresën se vërejtjet nuk do të merren personalisht sepse këtu, asnjëri prej neve nuk e prezentojmë vetveten., por njëgrumbullnjëzishetoseinteresat e caktuara qytetare.Gjithsesi, se jemi dakord dhe shpresojmë se do ta japim kontributin tonë në seancën e Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota "PËR" ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 9 të rendit të ditës, shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, nr.-II-1010, të dt.19.07.2023, raporti i Komisionit për vlerësimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale.

#### **X. Pika e dhjetë e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** –Në Bakshi, është një strehimore e qenve dhe me më pyet saktë nuk e di, por disa qytetarë më kanë shkruar se janë në hall prej asaj strehimoreje. Dikush ka pyet dhe ju kanë thënë se këtë leje për atëstrehimore e ka lëshuar Ministria. Unë jam interesue në Ministri, në AVUK dhe kanë thënë që jo, mirëpo në ndërkohë ata na kanë thënë se Komuna e ka lëshuar një leje të tillë. Nuk është kërkesë pretendive, por është kërkesë veçme ditë se a ka lëshuar dikush ndonjë leje të tillë sepse këta qenë po shkaktojnë telashe për qytetarët që jetojnë aty. Unë kisha pasë dëshirë që në seancën vijuese, kushdo që është për këto punë të na informoj. Kërkesa e dytë është se në mandatin e kaluar është themeluar Ansambli i qytetit të Obiliqit dhe kisha pasë dëshirë që në seancën e ardhshme me ditë se deri ku ka shkue, a është funksional ky Ansambël dhe a është gjithçka në rregullë si do të duhej të ishte.Kërkesa e tretë është se kemi disa vërejtje rreth ndriçimit në shumë rrugë dhe rrugica ka filluar dhe shumë dritat janë prishë, do të thotë nuk funksionojnë. Ne e dijmë se kjo është teknikë dhe ka mundësi të prishet, por ka qenë dashtë sepse sa e di unëkëminjëzyrtarë për ndriçimbrendaKomunës, me i përcjellëpak ose me dhënë një informacion se ku munden qytetarët me i bë vërejtjet, që ato të rregullohen. Pra, në shumë lagje duke u nisë prej aty ku banoj unë dhe në shumë lagje të tjera, ka vërejtje në Sibofc, Lajthishtë, në Milloshevë në disa lagje. Prandaj, është mirë me pa mundësinë se e di qëatojanë të harxhueshme dhe prishen, por me pa edhe mundësinë se a mund të rregullohen.Krejtë, e fundit kryesuese e kisha pasë një lutje në mënyrë që mos të përsëriten skenat në seanca dhe nuk ma merrë mendja se jemi rrugaç, sepse neve na ka zgjedhë dikush. Pra, ka qenë mirë që seancat të menaxhohen sa më mirë që është e mundur sepse ato po i shohin familjet tona, po i shohin qytetarët të cilët na kanë sjellë këtu.Me mendimin më tëmirëpa dashtë me bë vërejtje, nuk na ka hije me kaluar seancat në çështje personale dhe në fyerje të cilat nuk ju takojnë së paku zyrtarëveqë do tëduhej tëishinqyshtë kohës. Kemi disa shembuj në këtë mandat që ka fyerje të llojeve të ndryshme, ndoshta ndonjëherëedhe ne kemi rrëshqit në atëdrejtim, por besoj se nuk i bëjnë nder askujt. Unë kisha pasë lutje shumë të sinqertë ndaj juve, që seancat me i menaxhues sa më mirë që është e mundshme.

**Enver Gashi** –Çështja e ndriçimit z.Sami, nuk është vetëm te ju, por në përgjithësi në Komunëdhe dritat siç u tha janëprishëjanë material shpenzues, pornuk është lidhë kontrata me kompaninë për mirëmbajtje, janë procedurat byrokratike që po zgjasin dhe ky është faji kryesor. Pra, nuk është që nuk janë angazhuar të Komunës, por krejtë faji është te procedurat e tenderimit. Sa i përket strehimores së qenve, edhe unë jam interesuar dhe e kam pyetur inspeksionin dhe bujqësinë këtu, në Komunë dhe në bazë të informatave të mia leje nuk kanë lëshuar. Thuhet se dikush tjetër ka lëshuar leje prej së larti, por kush nuk e di.

**Kryesuesja** – Patjetër DSHPE-së, bujqësisë, inspeksionit ne do të ua përcjellim pyetjet në mënyrë që në seancën e Kuvendit, ju ti keni përgjegjet e duhura.

Mbledhja përfundoi në ora 11:29'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

